



Pjesa narrative e raportit gjashtë-mujor për konsultimet e kryera publike të Ministrisë së Financave dhe Ekonomisë

1. Përmbledhja ekzekutive (pasqyra e statistikave kryesore mbi konsultimet e kryera me mësimet e nxjerra, sfidat dhe mundësitë)

Gjatë periudhës janar-qershor të vitit 2021 sa i përket Ministrisë së Financave dhe Ekonomisë, në total janë miratuar **81 akte**.

Prej tyre, aktet e mëposhtme kanë qenë objekt i konsultimit publik:

- 1. VKM nr.7, datë 13.01.2021 “Për miratimin e kuadrit makroekonomik dhe fiskal, për periudhën 2022-2024”;*
- 2. VKM nr.37, datë 27.1.2021 “Për miratimin e programit të reformave ekonomike (ERP) 2021-2023”;*
- 3. VKM nr.38, datë 27.1.2021 “Për miratimin e Strategjisë Afatmesme të Menaxhimit të Borxhit 2021-2023”;*
- 4. VKM nr.136, datë 10.3.2021”P-Ligj për një ndryshim në ligjin nr.48/2014, “Për pagesat e vonuara në detyrimet kontraktore dhe tregtare”;*
- 5. VKM nr.284, datë 14.5.2021”P-Ligj për një ndryshim në ligjin 10081/2009, për licencat, autorizimet dhe lejet në RSh të ndryshuar.*

Nga aktet e mësipërme, **një akt është konsultuar përmes regjistrit elektronik**, përkatësisht: **“P-Ligji për një ndryshim në ligjin nr.48/2014, “Për pagesat e vonuara në detyrimet kontraktore dhe tregtare”**. **VKM nr.37, datë 27.1.2021 “Për miratimin e Programit të reformave ekonomike (ERP) 2021-2023”** është konsultuar, por **vetëm përmes postës elektronike dhe konsultimit në distancë**.

Nga këto dy akte të sipërcituara, vetëm VKM nr.37, datë 27.1.2021, “Për miratimin e Programit të reformave ekonomike (ERP) 2021-2023” është planifikuar në Programin e Përgjithshëm Analitik të Akteve.

Vlerësohet se procesi, në raport me të njëjtën periudhë të vitit të kaluar, gjashtëmujorin e parë 2020, ka patur përmirësime por jo shumë të dukshme dhe nevojitet të planifikohet më në detaje procesi i konsultimit publik duke evidentuar më konkretisht nevojat, burimet në dispozicion, afatet kohore, hapat që do të ndërmerren, veprimet që duhet të kryhen me përpikmëri.

2. Analiza e konsultimeve të kryera

2.1. Numri i përgjithshëm i akteve për të cilat janë kryer konsultimet publike

2.1.1. Cili ishte numri i përgjithshëm i akteve të miratuara në një vit të caktuar?

Në total gjatë kësaj periudhe janë miratuar 81 akte.

Nga këto 81 akte, një akt nuk ka qenë i planifikuar në Programin e Përgjithshëm Analitik të Akteve, dhe një akt është miratuar jashtë këtij Programi. Gjithashtu vetëm një akt referuar Programit të Përgjithshëm Analitik të Projektakteve, i është nënshtruar konsultimit publik.

2.1.2. Sa akte janë konsultuar dhe sa jo?

5 projekt akte kanë qenë objekt konsultimi. Prej tyre, 2 akte janë konsultuar dhe 3 akte nuk janë konsultuar. Për detaje lutem referohuni sikurse raportuar në pikën 1

2.1.3. Sa ligje me raporte VNR-je janë konsultuar?

Një VKM nr.136, datë 10.3.2021 P-Ligj për një ndryshim në ligjin nr.48/2014, "Për pagesat e vonuara në detyrimet kontraktore dhe tregtare" është konsultuar me raport VNR-je.

2.1.4. Për sa akte në a) Programin Analitik, b) PKIE, c) dokumente strategjike të sektorit, janë përdorur kriteret/përfundimet nga konsultimet publike? Cilat janë arsyet kryesore për të mos u konsultuar (nëse ka të tilla)?

Katër akte nuk janë konsultuar. Arsyet janë:

- Dokument teknik (VKM nr 38, datë 27.1.2021 "Për miratimin e Strategjisë Afatmesme të Menaxhimit të Borxhit (2021-2023)&VKM nr.7, datë 13.1.2021, "Për miratimin e kuadrit makroekonomik dhe fiskal, për periudhën 2022-2024");

- Ligji nuk ka ndryshuar, amendimi kaloi me procedure të përshpejtuar (VKM nr.284, 14.5.2021, "Për disa ndryshime në Ligjin Nr.10081, datë 23.02.2009, "Për licencat, autorizimet dhe lejet në Republikën e Shqipërisë", i ndryshuar).

- Akti është konsultuar me forma të tjera, por nuk është konsultuar nëpërmjet regjistrit elektronik (VKM nr.37, datë 27.1.202, "Për miratimin e programit të reformave ekonomike (ERP) 2021-2023")

2.1.5. Cila ishte struktura e akteve të konsultuara (sa projektligje, VKM, udhëzime, etj.)?

Është konsultuar 1 (një) dokument strategjik, por jo përmes regjistrit elektronik: VKM nr.37, datë 27.1.202, "Për miratimin e programit të reformave ekonomike (ERP) 2021-2023" si edhe një VKM nr.136, datë 10.3.2021"P-Ligj për një ndryshim në ligjin nr.48/2014, "Për pagesat e vonuara në detyrimet kontraktore dhe tregtare";

2.1.6. A është përmirësuar situata në krahasim me vitin e kaluar (cilësoni)?

Në 6-mujorin e parë të vitit 2020, referuar raportit vjetor 2020 për MFE, është konsultuar dhe miratuar një projekt akt. Gjatë 6-mujorit të parë të vitit 2021 janë konsultuar dy projekt-akte të miratuara. Duke ju referuar akteve të miratuara gjatë 6-mujorit të parë, situata në këto dy periudha paraqitet me disa përmirësime por jo të dukshme. Priten përmirësime në 6-mujorin e dytë, duke qenë se janë konsultuar disa projektakte dhe projektligje të cilat pritet ende të miratohen por që bazuar në Urdhrin nr. 3, datë 29.01.2021 të Sekretarit të Përgjithshëm të Këshillit të Ministrave " Për miratimin e Udhëzuesit për Procesin e Konsultimit Publik", në këtë raport raportohen vetëm aktet e miratuara gjatë 6 mujorit janar-qershor 2021 .

2.2. Metodatat e konsultimit

2.2.1. Cilat ishishin metodatat më të përdorura të konsultimit? (Jepni numrin e konsultimeve të kryera për secilën metodë - regjistri elektronik, posta elektronike, faqe interneti, takime publike, komitete këshillimore, etj.)

Regjistër elektronik (1 akt)

Postë elektronike dhe konsultim në distancë (1 akt).

2.2.2. Cila metodë konsultimi gjeneroi numrin më të madh të komenteve?

Për shkak edhe të situatës së krijuar nga pandemia shkaktuar nga COVID-19, numrin më të madh të komenteve e gjeneroi posta elektronike dhe konsultimi në distancë.

2.2.3. A organizoi institucioni konsultime paraprake në fazat e hershme të hartimit? Nëse po, në sa raste?

Kjo pikë nuk është e aplikueshme për periudhën janar – qershor 2021.

2.3. Kohëzgjatja e konsultimeve

2.3.1. Sa konsultime ishishin të hapura për 20 ditë pune siç kërkohet nga ligji? Cila ishte periudha më e gjatë apo më e shkurtër e kohëzgjatjes së konsultimeve?

P-Ligj për një ndryshim në ligjin nr.48/2014, “Për pagesat e vonuara në detyrimet kontraktore dhe tregtare”. Kohëzgjatja e konsultimit publik përmes regjistrit elektronik në RENJK zgjati nga data 27.11.2020 deri 27.12.2020, konkretisht në linkun:

<https://www.konsultimipublik.gov.al/Konsultime/Detaje/303>.

VKM nr.37, datë 27.1.202, “Për miratimin e programit të reformave ekonomike (ERP) 2021-2023”). Konsultimi u la i hapur për periudhën 1-muaj dhe jo në regjistrin elektronik).

2.3.2. Cila ishte kohëzgjatja mesatare e konsultimit?

Për të dyja aktet e sipërcituara kohëzgjatja e konsultimit ka qënë 1 muaj (20-21 ditë pune).

2.3.3. A është përmirësuar situata në krahasim me vitet e kaluara?

Në krahasim me vitin e kaluar situata nuk ka pasur përmirësime të dukshme të procesit të konsultimit, pasi interesi i publikut në procesin e konsultimit publik vijon të jetë ende i ulët.

Të dhënat e përfutuara nga Regjistri Elektronik për Njoftimet dhe Konsultimet Publike tregojnë se numri i vizitorëve ka qënë në ulje.

Vlerësojmë se një faktor që mund të ketë ndikuar në mungesën e reagimeve nga ana e publikut ka qënë dhe situata e krijuar nga pandemia shkaktuar nga COVID-19.

2.4. Palët e interesuara të përfshira

2.4.1 Sa aktorë të jashtëm, jo-qeveritarë morën pjesë për hartimin e akteve si anëtarë të caktuar të grupeve të punës/organeve këshillimore në vitin e caktuar?

Gjatë hartimit të VKM nr.37, datë 27.1.202, "Për miratimin e programit të reformave ekonomike (ERP) 2021-2023", nuk morën pjesë aktorë të jashtëm. Hartimi ishte në ngarkim të Ministrisë së Financave dhe Ekonomisë, Ministrive të Linjës si dhe Bankës së Shqipërisë.

Lidhur me P-Ligjin për një ndryshim në ligjin nr.48/2014, "Për pagesat e vonuara në detyrimet kontraktore dhe tregtare" morën pjesë Perfaqësues të Bashkimit të Dhomave të Tregtisë dhe Industrisë

2.4.2 Cila ishte struktura e anëtarëve të jashtëm të grupeve të punës (ekspertë individualë, OSHC, kompani, etj.)

Lidhur me P-Ligjin për një ndryshim në ligjin nr.48/2014, "Për pagesat e vonuara në detyrimet kontraktore dhe tregtare", ka patur eksperte të jashtëm të kontraktuar nga KM për hartimin e RIA të projektligjit, përkatësisht Z. Kastriot Sulka.

2.4.3 Sa palë të interesuara morën pjesë/dhanë komente në konsultimet e hapura të realizuara për projekt-aktet në vitin e caktuar?

Lidhur me VKM nr.37, datë 27.1.202, "Për miratimin e programit të reformave ekonomike (ERP) 2021-2023", njëmbëdhjetë palë morën pjesë në konsultimet e hapura.

Lidhur me P-Ligjin për një ndryshim në ligjin nr.48/2014, "Për pagesat e vonuara në detyrimet kontraktore dhe tregtare, nuk raportohet asnjë koment.

2.4.4 Cila ishte struktura e kontribuesve në konsultimet publike, sa persona, sa persona juridikë (ndërmarrje, shoqata, etj.)?

Lidhur me VKM nr.37, datë 27.1.202, "Për miratimin e programit të reformave ekonomike (ERP) 2021-2023", struktura e kontribuesëve paraqitet si mëposhtë:

Ambasadat (tre), banka ndërkombëtare (dy), institute të kredisë (një), shoqata bashkëpunimi (tre), agjensi të organizatave ndërkombëtare (një), agjensi zhvillimi (një).

Lidhur me P-Ligjin për një ndryshim në ligjin nr.48/2014, "Për pagesat e vonuara në detyrimet kontraktore dhe tregtare struktura e kontribuesëve përbëhet nga përfaqësues të Dhomave dhe Bashkimit të Dhomave të Tregtisë dhe Industrisë.

2.4.5 A është përmirësuar situata në krahasim me vitet e kaluara?

Vihet re përmirësim por jo shumë i dukshëm, krahasuar me 2020.

2.5. Rekomandimet dhe komentet e marra

2.5.1. Sa është numri i rekomandimeve dhe komenteve të marra gjithsej dhe mesatarja për çdo konsultim?

Komentet janë marrë vetëm për një akt dhe ishin mbi 9 (nëntë) komente, përkatësisht mbi:

“VKM nr.37, datë 27.1.202, “Për miratimin e programit të reformave ekonomike (ERP) 2021-2023”;

Mbi P-Ligjin për një ndryshim në ligjin nr.48/2014, “Për pagesat e vonuara në detyrimet kontraktore”, nuk ka patur asnjë koment.

2.5.2. *Sa prej tyre u pranuan, u pranuan pjesërisht ose u refuzuan?*

Komentet janë marrë vetëm për një akt sikurse raportuar më sipër dhe ishin mbi 9 (nëntë) komente të pranuar.

2.5.3. *Cila është tendenca nëse krahasohet me vitet e kaluara?*

Vihet re përmirësim por jo i dukshëm krahasuar me të njëjtën periudhë të vitit 2020.

2.5.4. *Sa raporte të VNR-së janë ndryshuar/përditësuar në bazë të informacionit/të dhënave të marra gjatë konsultimit publik?*

Për P-Ligjin për një ndryshim në ligjin nr.48/2014, “Për pagesat e vonuara në detyrimet kontraktore dhe tregtare”, VNR që shoqëron projektligjin, është përditësuar me informacion zyrtar të percjellë nëpërmjet MSHMS.

2.6. Raportet mbi rezultatet e konsultimit

2.6.1. *Sa raporte konsultimi publikoi institucioni?*

Asnjë raport nuk është publikuar në regjistër. Një projekt akt i konsultuar nuk është hedhur në regjistrin elektronik, por është konsultuar vetëm përmes postës elektronike, konsultimit në distancë.

2.6.2. *Nëse disa nuk u publikuan, cilat janë arsyet?*

Strukturat propozuese të akteve nuk planifikuan, njoftuan dhe e gjykuan të nevojshëm konsultimin publik përmes regjistrin elektronik. Forma të tjera të konsultimit u ndoqën.

2.7. Vetëvlerësimi i institucionit në lidhje me Indeksën e cilësisë së performancës institucionale në përputhje me kërkesat e ligjit për njoftimin dhe konsultimin publik (Jepni informacion për rezultatin mesatar për të gjitha aktet e institucionit, subjekt të konsultimeve publike, bazuar në pikët e rezultateve në Shtojcën 5c)

Cilësia e performancës institucionale referuar ligjit për njoftimin dhe konsultimin publik ka hapësirë për përmirësim veçanërisht në drejtimet e mëposhtme:

- Metodot e konsultimit;
- Marrja e komenteve apo sugjerimeve të ndryshme dhe reflektimi i tyre si edhe dhënia e një feedback-u në këtë kuadër;
- Planifikim më i mirë i planit vjetor nga hartuesit dhe respektimi i afateve nga ana e Drejtorive propozuese referuar këtij plani.

3. Sfidat dhe mundësitë për të ardhmen *(Cilat janë sfidat kryesore në organizimin dhe zbatimin e konsultimeve në ministri dhe si duhet dhe do të adresohen ato në periudhën tjetër të raportimit?)*

Sfidat kryesore që paraqet konsultimi publik lidhen më së shumti me gjithëpërshirjen e aktorëve në këtë proces. Ministria e Financave dhe Ekonomisë ende nuk ka përfshirje aktive të aktorëve në procesin e dhënies së rekomandimeve apo qëndrimeve për përmbajtjen e projektakteve që hartohen.

Kombinimi dhe përdorimi i disa metodave të procesit të konsultimit publik vlerësohet si mundësia më e mirë për të arritur një rezultat efikas në të ardhmen. Gjithashtu vlerësohet se edhe angazhimi nëpërmjet rrjeteve sociale duke u realizuar edhe në kombinim me metodat e tjera të konsultimit publik do të sjellë ritje të përfshirjes dhe mundësive në këtë kuadër.